



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 24 janar 2018

Komunikatë për media

ZRRE kërkon nga KESCO furnizim të rregullt me energji elektrike pa reduktime

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), njofton opinionin e gjerë se në bazë të autoritetit të saj ligjor, në vazhdimësi është duke monitoruar operimet dhe sjelljet e operatorëve të sistemit të energjisë elektrike në vend. Sipas informatave të ditëve të fundit, të pranuar nëpërmjet ankesave nga konsumatorët, raportimeve të mediave të shkruara dhe elektronike, është vërejtur se Operatori i Furnizimit me Energji (KESCO) është duke aplikuar reduktime të energjisë elektrike në lokalitete të ndryshme në vend. ZRRE ka reaguar menjëherë, duke dërguar shkresë zyrtare tek KESCO përmes të cilës ka kërkuar nga ajo furnizim të rregullt me energji elektrike dhe ndërprerje të menjëhershme të reduktimeve përveç në rastet kur rrezikohet siguria e sistemit.

ZRRE kërkon edhe njëherë nga të licencuarit që të angazhohen maksimalisht për mbarëvajtjen e operimit të sistemit, dhe furnizim të rregullt me energji elektrike.